



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 17.01.2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Jasmina Zhivković, Fisnik Ismaili dhe Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë: OSBE, INPO, KDI dhe RTK.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.12.2017;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit, për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2018;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.12.2017**

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit, për vitin 2017**

Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për mbledhjen e radhës.

### **4. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2018**

**Nait Hasani**, tha se komisioni do të jetë i ngarkuar me shqyrtimin e p/ligjeve të cilat sipas strategjisë legjislative janë gjashtë dhe tri të tjera të cilat komisioni i ka në procedurë sipas nismës legjislative të komisionit.

Komisioni shqyrtoi draft- planin e punës së komisionit për vitin 2018 dhe propozoi plotësimet dhe ndryshimet si vijon:

Për muajin janar – Komisioni propozoi shqyrtimin e Raportit për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2016;

Për muajin maj - u propozua që në plan të punës të inkorporohet P/ligji për RTK-në, me arsyetimin se komisioni do të hartojë draft- tekstin, pastaj e dërgon në Qeveri për mendim, konform Rregullores së Kuvendit, ndërsa në muajin maj e shqyrton draftin për miratim në parim; Për muajin qershor - u propozua që bashkë me P/ligjin për Qeverinë të shqyrtohet edhe P/ligji për Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Për muajin shtator – u propozua që komisioni të shqyrtojë edhe plotësim ndryshimin e Ligjit për Procedurën e përgjithshme administrative, në fuqi bashkë me P/ligjin për Kontestet administrative;

Komisioni vendosi që të monitorojë zbatimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Procedurën e përgjithshme administrative.

Konstatim: Komisioni unanimisht miratoi në parim draft-planin e punës për vitin 2018, me ndryshimet dhe plotësimet e sipërshënuara.

### **5. Të ndryshme**

Komisioni diskutoi për shkresën e RTK-së, adresuar komisionit, me të cilën RTK, kërkon nga Kuvendi që të gjejë një zgjidhje për shfrytëzimin e hapësirave në ndërtesën e Radio- Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën:11:25.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----

Nait Hasani